



Për: Mediat e shkruara dhe elektronike
Nga: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun
Subjekti: Grupi Parlamentar i AKR-së, viziton Suedinë

Prishtinë, 5 maj 2008

Grupi Parlamentar i AKR-së viziton Suedinë

Me ftesë të Partisë Popullore Liberale të Suedisë, nga data 7 deri më 10 Maj, një delegacion i Grupit Parlamentar të Aleancës Kosova e Re i udhëhequr nga nën-kryetari i kësaj partie dhe njëherësh, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, z. Ibrahim Gashi, do të vizitojnë Parlamentin dhe Qeverinë e Suedisë.

Kjo është vizita e parë, që një delegacion i AKR-së, njëherësh edhe i Kuvendit të Kosovës, viziton Institucionet më të larta suedeze, pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

Në kuadër të kësaj vizite delegacioni i AKR-së do të ketë takim me Ministren e Integritimeve Evropiane, znj. Cecilia Malmström, me udhëheqës të lartë të Parlamentit Suedeze, me Partinë Popullore Liberale, e cila aktualisht është pjesë e Qeverisë së Suedisë, dhe me komunitetin shqiptar në Stokholm.

Qëllimi i kësaj vizite do të jetë ngritja e marrëdhënieve ndër-parlamentare në një nivel më të lartë të bashkëpunimit, duke marrë në konsideratë, ndihmën e madhe dhe kontributin e vazhdueshëm të shtetit suedeze për Kosovës.

Gjithashtu Grupi Parlamentar i AKR-së, është ftuar në solemnitetin shtetëror të Parlamentit Suedeze të organizuar për nder të festës së Evropës, më 9 Maj.